



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.9764/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Rustem Thaqi - kryetar i kolegjit, Zenel Leku dhe Faton Ademi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve - propozuesve të sigurimit: Sh.K. dhe M.K. nga Prishtina, të cilët i përfaqëson F. H. Sh., avokat në Prishtinë, sipas autorizimit, kundër të paditurës - kundërshtares së sigurimit: Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave - Komisioni i Kërkesave Pronësore (AKKVP), me seli në Prishtinë, Qyteza Pejton, rr. “Perandori Justinian” nr. 71, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar Ali Dragusha, sipas autorizimit, për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të paditësve - propozuesve të sigurimit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.6475/21, i datës 04.11.2021, në seancën jo publike, të mbajtur me datën 25.01.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e autorizuarit të paditësve - propozuesve të sigurimit: Sh.K. dhe M.K. nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.6475/21, i datës 04.11.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, C.nr.6475/21, i datës 04.11.2021, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të: Refuzohet i pabazuar propozimi i propozuesve të sigurimit: Sh. dhe M.K. nga Prishtina, me të cilën kanë kërkuar të caktohet masa e sigurimit, ashtu që kundërpropozuesit të sigurimit: “Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave - Komisioni i Kërkesave Pronësore, me seli në Prishtinë - Qyteza Pejton, ti ndalohet ta bëjë ngarkimin, tjetërsimin - shitjen e banesës, e cila gjendet në rr. “.....” (ish R.S.) me numër Kati ..., Hyrja ..., nr.... në Prishtinë, si dhe t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe përfaqësimit sipas Tarifës së Avokatëve. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që: Procedura në këtë çështje juridike kontestimore do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe planit të punës së gjykatës.

Kundër këtij aktvendimi i autorizuari i paditësve - propozuesve të sigurimit, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, mos zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës së Kushtetues dhe mos cenimit të dispozitave nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e paraqitur nga paditësit - propozuesit e sigurimit për caktimin e masës së sigurisë, ndryshohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë sa i përket masës së sigurisë, të caktohet masa e sigurisë dhe i ndalohet të paditurës - kundërshtares së sigurimit dhe palëve të treta që të bëjnë ngarkimin, tjetërsimin, shitjen e banesës ose çështja të kthehet në rivendosje në të njëjtën gjykatë dhe detyrohet e paditura të bëjë kthimin çelësive paditëses dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës dhe përfaqësimit sipas TA.

Me përgjigje në ankesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës - kundërshtares së sigurimit ka propozuar që të refuzohet e pabazuar ankesa e propozuesve ndërsa aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet i bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e autorizuarit të paditësve - propozuesve të sigurimit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit - propozuesit e sigurimit, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 24.08.2021, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, kundër të paditurës - kundërshtares së sigurimit, me të cilën kanë kërkuar që të: 1. Aprovohet në tërësi kërkesëpadija e ushtruar nga paditësit znj. Sh.K. dhe z. M.K. si e bazuar, 2. Vërtetohet se znj. Sh.K. e lindur me datë me numër personal dhe z. M.K., i lindur me datë me numër personal si pasardhës të z. I.K. ish nga Prishtina janë pronarë legjitim të banesës e cila gjendet në Lagjen “.....” E, Hyrja, nr.... Prishtinë, III. Detyrohet e paditura Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave - Komisioni i Kërkesave Pronësore, të bëjë kthimin e çelësive paditëses dhe në pagesën e shpenzimeve të procedurës dhe përfaqësimit sipas TA. Po ashtu me parashtrësën e datës 27.08.2021 ka paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurisë, duke kërkuar që të: 1. Aprovohet në tërësi propozimi i znj. Sh.K. dhe z. M.K. nga Prishtina për caktimin e masës së sigurisë ashtu që: 2. Caktohet masa e sigurisë dhe i ndalohet të paditurës Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave - Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës, adresa: Qyteza Pejton Komuna Prishtinë dhe palëve të treta që të bëjnë ngarkimin, tjetërsimin, shitjen e banesës e cila gjendet në rr. “.....” (ish R.S.) Banesa nr., Kati i, Hyrja, nr.... në Prishtinë, III. Detyrohet e paditura Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave - Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës, në pagesën e shpenzimeve të procedurës dhe përfaqësimit sipas TA.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të paditësve - propozuesve të masës së sigurisë, për vlerësimin e masës së sigurisë, ka caktuar seancën për shqyrtimin e masës së sigurimit, në të cilën është bërë deklarimi i të autorizuarve të palëve, janë administruar provat dhe pas përfundimit të shqyrtimit është marr aktvendimi i atakuar C.nr.6475/21, i datës 04.11.2021, me të cilin është vendosur që të: Refuzohet në tërësi

si i pabazuar propozimi i paditësve - propozuesve të sigurimit, për caktimin e masës së sigurisë, me çka edhe ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: duke vendosur sipas propozimit të propozuesve, ka bërë shikimin në propozim me shkrim të propozuesve për caktimin e masës së sigurimit dhe provave, njëherit duke vlerësuar edhe theksimet e të autorizuarit të tij të dhëna në seancë. Duke marr për bazë këto, gjykata ka arritur deri tek vërtetimi i gjendjes faktike vetëm për sa i përket propozimit për masë, pa u lëshuar në vlerësime përmbajtjesore lidhur me epilogun përfundimtar që mund të ketë vendosja meritorë e kontestit. Pas analizimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe theksimeve të palëve ndërgjyqëse në seancë dëgjimore, gjykata ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse - propozuesve për caktimin e masës së sigurisë në rrethanat aktuale, është i pabazuar. Gjykata pasi bëri analizimin e shkresave të bashkëngjitura propozimit, e ka refuzuar masën e sigurimit të propozuar nga ana e paditësve - propozuesve, duke gjetur se në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet të cilat i kërkon neni 297.1 pika a) dhe b) dhe në mbështetje të nenit 300 të LPK-së, për caktimin e masës së sigurimit. Sipas vlerësimit të gjykatës për tu caktuar masa e sigurisë duhet të bëhet i besueshëm edhe elementi i rrezikut, i vënë si kusht i domosdoshëm nga LPK, ashtu që pa caktimin e masës, palës propozuese do ti vështirësohej në masë të konsiderueshme realizimi i kërkesës së saj subjektive në raport me atë çka paraqet objekt kontesti. Gjykata ka vlerësuar se nuk është bërë i besueshëm as kushti i rrezikut se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjerave ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit, për faktin që kundërpropozuesja nga provat që gjenden në shkresa të lëndës nuk tregohet se është titullari i së drejtës pronësore, mbi pronën në të cilën është kërkuar të caktohet masa e sigurisë, rrjedhimisht nuk ekziston rreziku i ngarkimit, tjetërsimit - shitjes së banesës, ngase nuk mund të ngarkohet e as të tjetërsohet e drejta që nuk posedohet. Ka shtuar se vendosja për masën e sigurimit të kërkesëpadisë, nuk ka të bëjë me vendosjen përfundimtare të çështjes kontestuese dhe nuk është bërë vlerësimi i fakteve në atë mënyrë që, në ndonjë mënyrë mund të aludonte në mënyrën e vendosjes përfundimtare, porse në këtë fazë gjykata mbështetet në dy kushtet e vëna nga neni 297 i LPK-së, që ka të bëjë me bërjen e besueshme të së drejtës subjektive (297.1, pika a) dhe kushti tjetër që ka të bëjë me rrezikun se pa caktimin e masës së tillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës (neni 297.1, pika b).

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ju ka referuar neneve 142 paragraf 5, 297 paragraf 1, pika a) dhe b), 300, 304 paragraf 3, 306 dhe 387 paragraf 1, pika 1 të LPK-së, nenit 361 paragraf 1 të LMD-së, nenit 2 paragraf 4, 4 paragraf 1 dhe 31 të Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronave, lidhur me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk

është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit, kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditësve - propozuesve të masës së sigurimit se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktvendimi i atakuar është i qartë si ne pjesën e dispozitivit dhe atë të arsytimit dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë edhe arsye të mjaftueshme rreth mënyrës së vendosjes dhe fakteve vendimtare. Një mënyrë e tillë e vendosjes sipas vlerësimit të gjykatës ankimore ka mbështetje në provat nga shkresat e lëndës dhe në ligj dhe se aktvendimi i atakuar përmban të gjitha elementet ligjore të parapara me dispozitën e nenit 160 e lidhur me nenin 175 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se propozimi për caktim të masës së sigurimit të kërkesëpadsisë është në tërësi i pabazuar.

Gjykata e Apelit e ka pranuar përfundimin e gjykimit të shkallës së parë, për refuzimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadsisë, për faktin se propozuesit e sigurimit nuk kanë arritur ta bëjnë të besueshme kërkesën për të drejtën subjektive dhe ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së propozuesve të sigurimit, për arsye se:

Me nenin 297 paragrafi 1 pika a) dhe b), përcaktohet në mënyrë të qartë se: “ Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtën subjektive të tij, në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit, por që këto dy kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

Po ashtu me nenin 304 paragraf 3 të LPK-së, përcaktohet se: “ Në propozimin për caktimin e masave të sigurimit propozuesi i sigurimit duhet ta tregojë në të kërkesën, për sigurimin e të cilës bënë propozim, masën e sigurimit që e propozon, mjetet dhe objektin e masës së sigurimit. Në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadsia, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim. Propozuesi i sigurimit ka për detyrë po që se ka mundësi, që mjetet provuese t’ia bashkëngjijtë propozimit “.

Gjykata e Apelit e ka pranuar përfundimin e gjykimit të shkallës së parë, për refuzimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadsisë edhe për faktin se: propozuesit gjykatës nuk ja kanë bërë të besueshme kërkesën apo të drejtën e tyre subjektive dhe ekzistimin e rrezikut për dëmin i cili mund ti shkaktohet atyre, me veprimet të cilat kundërshtarja e masës së sigurimit i ka ndërmarrë dhe mund ti

ndërmerr në të ardhmen, lidhur me paluajtshmërinë kontestuese e cila evidentohet si njësi kadastrale me numër, në të cilën gjendet banesa, Kati, Hyrja, nr..., Prishtinë, mirëpo në shkresat e lëndës nuk ka prova të cilat e mbështesin të drejtën subjektive të paditësve - propozuesve të sigurimit në raport me kundërshtaren e sigurimit.

Përveç të cekurave në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë që vërtetojnë faktin se e paditura këtu kundërshtarja e sigurimit ka ndërmarr ndonjë veprim ku do të ndryshohet rrënjësisht gjendja ekzistuese dhe do të shkaktohet dëm i pariparueshëm palës paditëse gjegjësisht propozuesve të sigurimit si: shpallja publike për shitje, negociata me ndonjë person të tretë, ndërmarrja e ndonjë veprimi tjetër në çfarëdo mënyre që do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjerave etj..) dhe se mos caktimi i masës së sigurisë nga ana e propozuesve nuk paraqet asnjë rrezik për palët në këtë rast.

Edhe pse në këtë rast Gjykata e Apelit ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit, kjo nuk do të thotë se në të ardhmen pala paditëse - propozuesit e sigurimit me ndryshimin e rrethanave nuk mund të kërkojnë caktimin e masës së sigurimit dhe në këtë kuptim palët e as gjykata nuk mund të thirrën në çështje të gjykuar - res iudicata, por pala paditëse - propozuesit e sigurimit në çdo kohë mund të kërkojnë caktimin e masës së sigurimit, me kusht që kanë për detyrë të vërtetojnë ndryshimin e rrethanave që kanë ekzistuar me rastin e vendosjes nga gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoj edhe të gjitha pretendimet tjera të palës paditëse - propozuesve të sigurimit sa i përket propozimit për caktimin e masës së sigurimit, mirëpo të njëjtat ishin pa ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.9764/21, me datë 25.01.2022

Kryetari i kolegjit
Rrustem Thaqi, d.v